3) **Paragjykimet etnike dhe stereotipet.** Konfliktet dhe armiqësitë që kanë shënuar historikisht marrëdhëniet mes popullit serb dhe atij shqiptar në Ballkanin Perëndimor kanë përcjellë stereotipe dhe përgjithësime të ngulitura thellë dhe perceptime të ndërsjella. Këto paragjykime kanë prekur shumë gjenerata të serbëve dhe shqiptarëve dhe kanë bërë që ata të perceptojnë njëri-tjetrin si rivalë dhe antagonistë. Këto perceptime armiqësore vërehen në pothuajse çdo shtresë të dinamikës socio-politike në Kosovë, duke përfshirë diskursin publik,



ndjenjat fetare, plan programin mësimor, sjelljen e pranueshme nga shoqëria etj. Idetë e tilla sociale e rëndojnë procesin e pajtimit etnik dhe normalizimit, duke krijuar qëndrime të dëmshme midis komuniteteve të Kosovës, siç është miratimi i dhunës, parandalimi i empatisë ndaj viktimave, injorim të të drejtave legjitime dhe interesave të komunitetit që i nënshtrohet perceptimit stereotipik, etj...

Ka shumë hulumtime dhe dokumente për studimin e shkaqeve të dy konflikteve të para. Megjithatë, jo shumë përpjekje janë bërë për identifikimin e paragjyqimeve dhe keqkuptimeve që ngarkojnë marrëdhëniet etnike në Kosovë, e sidomos jo në angazhim për dialog publik që synon dekonstruktimin e tyre. Studimi i paraqitur në këtë dokument tenton pikërisht këtë - të tregojë stereotipet mbizotëruese etnike dhe të nisë një dialog të hapur që çon drejt të kuptuarit të tyre dhe refuzimit për krijimin e perceptimeve etnike.

Hulumtimi është kryer me 527 të anketuar nga Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani, Zubin Potoku, dhe enklavat (Shtërpcë, Gjilan dhe Graçanicë) në një të anë (gjithsej 233), dhe nga Mitrovica dhe Prishtina (gjithsej 299) në anën tjetër. Mostra është uniforme sipas gjinisë. Përqindja më e madhe e të anketuarve kanë të përfunduar fakultetin (46.1), të mesmen (35.7%), 13.9% të lartën, dhe vetëm 4.4% filloren; më së shumti ka të punësuar (47.6%), përqindje disi më e ulët e të papunëve (31.5%), nxënës 14.8% dhe pensionistë 6.1%. Moshë mesatare e të anketuarve është 36 vjet (vlera maksimale është 81, minimumi 15). Pjesëtarë të nacionalitetit serb janë deklaruar 228 të anketuar, kosovarë dhe goranë nga një, dhe boshnjak janë 2 të anketuar; Shqiptarë e konsiderojnë veten gjithsej 153 prej të anketuarve, 132 kosovarë, rom një, pjesëtar të nacionalitetit turk 4 persona dhe 2 persona të cilët deklarohen boshnjakë.

## VËZHGIMET KRYESORE

- Analiza e rezultateve tregon se pothuajse 80% edhe të popullsisë serbe edhe të asaj shqiptare mund të pranojnë marrëdhënie më të ngushta të bashkëpunimit, me pjesëtarë të etnisë së kundërt.
- Pjesëtarët e komunitetit serb në mesatare (AS=7,4) shfaqin distancë më të madhe etnike ndaj shqiptarëve në krahasim me distancën mesatare etnike (AS=6.1) të cilën pjesëtarët e komunitetit shqiptar e shfaqin ndaj serbëve.
- Pjesëtarët e komunitetit serb i konsiderojnë shqiptarët dyfyturësh, agresiv, të dhunshëm, të thjeshtë, dinak dhe nacionalistë; ndërsa pjesëtarët e komunitetit shqiptar konsiderojnë se serbët janë nacionalistë dhe persona fetarë.
- Në kontekstin e gatishmërisë për pajtim, pjesëtarët e komunitetit shqiptar kanë treguar tendencë më të lartë drejt pajtimit (AS=32.55) në krahasim me pjesëtarët e komunitetit serb (AS=25.26). Ku anëtarët e komunitetit shqiptar (42.5%) zgjidhjen për afrimin ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve e shohin duke u bashkuar në BE, ndërsa pjesëtarët e komunitetit serb mundësinë e afrimit e shohin në bashkëpunimin ekonomik të popujve (31.8%). Në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb ka edhe të tillë që besojnë se serbët dhe shqiptarët nuk mund të pajtohen (28.3%).
- Rezultatet tregojnë se një përqindje e lartë e pjesëtarëve të komunitetit serb kishin pasur rastin që kenë bashkëpunim afarist (65.7%) dhe privat (73.4%) me pjesëtarët e komunitetit shqiptar, ku më së shumti prej tyre ka që kanë pasur edhe përvoja pozitive edhe negative në këto bashkëpunime (43.3% për afariste dhe 48.1% për ato private). Nga 100% e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar, 49.3% kanë pasur rastin që të kenë bashkëpunim afarist kurse 69.7% të bashkëpunojnë privatisht me pjesëtarët e komunitetit serb; ku përqindja më e lartë (32.3% për afarist dhe 32.3% për privat) veçoi se ata kishin eksperiencën edhe pozitive edhe negative me rastin e këtyre bashkëpunimeve.
- Lidhur me situatën e pafavorshme socio-ekonomike, ekziston një pajtim i pjesshëm në faktorët e ndarë në të dy komunitetet. Pjesëtarët e komunitetit serbe shkakun e shohin në konfliktet etnike (32.6%), paaftësinë e politikanëve të cilësdo përkatësie etnike (24.9%) dhe në paaftësinë e shqiptarëve për të udhëhequr Kosovën (21.9%); kurse pjesëtarët e komunitetit shqiptar shkakun e shohin në paaftësinë e politikanëve të secilës përkatësie etnike (32.7%) dhe paaftësinë e shqiptarëve për të udhëhequr Kosovën (27.9%).
- Shkalla e manifestimit të identitetit kombëtar dhe religjionit së bashku parashikojnë 6% variancë të gatishmërisë për pajtim (100%), ku rezultatet tregojnë se sa më pak fetar që është një person dhe se sa më pak të jetë i theksuar identiteti kombëtar aq më e madhe gatishmëria për pajtim të këta persona. Duhet të theksohet se pjesëtarët e të dyja komuniteteve në mënyrë të barabartë shfaqin një shkallë të lartë të identitetit kombëtar dhe një shkallë të lartë të religjiozitetit, kurse gati gjysma e komunitetit shqiptar (49.7%) dhe më shumë se gjysma e pjesëtarëve të komunitetit serb (69.5%) besojnë se jotoleranca ndaj pjesëtarëve të feve të ndryshme rrezikon paqen në territorin ku jetojnë.

- E rëndësishme është e dhëna se edhe për pjesëtarët e komunitetit shqiptar (88.5%) edhe për pjesëtarët e komunitetit serb (84.5%) është që të arrihet pajtimi në mes të serbëve dhe shqiptarëve për hir të funksionimit normal të brezave të ardhshëm.


## REZULTATET

### 1. Distanca sociale dhe stereotipet etnike te popullata serbe dhe shqiptare

Ekipi hulumtues për qëllime të këtij studimi ka përdorur përkufizimin e standardizuar dhe shkallën për matjen e distancës sociale të cilën e ka bërë Bogardus sipas të cilit distanca sociale ka të bëjë me nivelin e të kuptuarit, afërsinë psikologjike (ose largësinë) të një individi ose grupi në raport me tjetrin, të individëve apo grupeve të ndryshme. Distanca sociale shqyrtohet si gatishmëri për të krijuar një marrëdhënie me afërsi të ndryshme.

Shkalla e Bogardusit përbëhet nga 12 pohime të pranimit social dhe detyra e të anketuarve ishte që të tregojnë shkallën e afërsisë me një pjesëtar të kombësisë së kundërt që është e pranueshme për ta. Shkalla është e standardizuar dhe plotësisht merr formulimet e pretendimeve të krijuara nga Bogardus, edhe pse ato janë në kundërshtim me atë që konsiderohet të jetë një retorikë publike e pranueshme; për shembull, shprehja "Unë do t'i zhdukja ata nga faqja e dheut" që klasifikon një qëndrim jashtëzakonisht negativ ndaj një grupi tjetër etnik. Rezultatet janë paraqitur në grafikun 1.

**Grafiku 1 – shfaqja e distancës etnike të pjesëtarëve të komunitetit serb ndaj shqiptarëve; dhe komunitetit shqiptar ndaj serbëve**



Duke parë grafikun mund të shohim se përqindja më e madhe e pjesëtarëve të komunitetit serb (30.5%) i pranojnë shqiptarët si qytetarë të shtetit të tyre, ndërsa përqindja e atyre që kanë percepton tejet negativ sipas një shkallë të standardizuar është e papërfillshme (që shqiptarët duhet zhdukur nga faqja e dheut 0.3%). Nga ana tjetër, përqindja më e madhe e komunitetit shqiptar ka shënjuar se mund të pranojë një serb si qytetar të vendit të tij (20.1%), por edhe si mik personal (18.7%); ndërkohë që për pranimin e një serbi si shef në vendin e punës shkalla e afërsisë e treguar nga një përqindje e vogël e popullsisë shqiptare (2.4%). Analiza e rezultateve tregon se pothuajse 80% edhe e popullsisë serbe edhe asaj shqiptare mund të pranojë marrëdhënie më të ngushtë të bashkëpunimit, me një anëtar të kombësisë së kundërt që është një e dhënë inkurajuese për mendimin e një strategjie për përmirësimin e bashkëpunimit etnik në Kosovë.

Për të kontrolluar se kush përgjithësisht shpreh mesatarisht distancë më të madhe etnike, komuniteti serb ndaj shqiptarëve apo komuniteti shqiptar ndaj serbëve, kemi kryer një “test” analizë të mostrave të pavarura (Tabela 1), e cila shërben për të krahasuar rezultatet e dy kategorive të të anketuarve.

**Tabela 1 – testimi i rëndësisë së dallimeve në shkallën e shprehur të stereotipit etnik te pjesëtarët e komunitetit serb dhe shqiptar**

Statistika përshkruese	t test				
	AS	SD	t	df	p
<b>Shkalla e distancës sociale të shprehur (mesatarja)</b>					
pjesëtarët e popullsisë serbe	7,4	3,1	4,9	525	0,00
pjesëtarët e popullsisë shqiptare	6,1	3			

Legjenda: AS – Mesi aritmetik; DS – devijimi standard; N – numri i të anketuarve; t – vlera e statistikave; df – shkallët e lirisë; p – rëndësia e statistikave.

Rezultatet tregojnë se pjesëtarët e komunitetit serb mesatarisht (AS=7.4) shprehin distancë etnike më të madhe ndaj shqiptarëve në krahasim me distancën mesatare etnike (AS=6.1) të cilën pjesëtarët e komunitetit shqiptar e shfaqin ndaj serbëve. Përkatësisht, komuniteti serb tregon rezerva më të mëdha në drejtim të ndërveprimeve sociale me komunitetin shqiptar në raport me komunitetin shqiptar dhe gatishmërinë e tyre për ndërveprime sociale me komunitetin serb. Duhet të theksohet se ky studim nuk është marrë me hulumtimin e shkakut të kësaj dukurie.

Megjithatë, në kuadër të hulumtimit janë mbajtur edhe fokus grupe (të ndara me pjesëtarët e komunitetit serb dhe shqiptar), një nga pyetjet në këtë fazë të hulumtimit ka pasur të bëjë me interpretimin e rezultateve të shprehura në aspekt të distancës etnike të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe shqiptar. Si arsyeja më e madhe e shprehjes së distancës etnike në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb pjesëmarrësit në të dy grupet e fokusit përmendin në një rënë anë ndjenjën e të qenit të rrezikuar në mesin e serbëve, sepse ata janë pakicë në këto vise, dhe në anën tjetër, pas shpalljes së pavarësisë shqiptarët mendojnë se kanë "çdo gjë që kanë dëshiruar" kështu që nuk kanë një motivim të fortë për t'i konsideruar pjesëtarët e komunitetit serb si armiq.

Një term që është i lidhur ngushtë me distancën sociale është ai i stereotipit (stereotipeve etnike). Stereotipet përkufizohen si imazhe mendore të shtrembëruara të cilat nuk janë të bazuara në përvojën e individit, por janë të kushtëzuara kulturalisht (Lippmann 1946: sipas Mihić et al, 2016:306), zakonisht reflektohet në tendencën për të nxjerrë në pah

pozitivisht sa më shumë kombin e vet, me ç'rast kombet tjera diskriminohen, përkatësisht atyre u veshën veti “më negative” (Tajfel, 1970, sipas: Mihić et al, 2016:306). Stereotipet etnike zhvillohen shumë herët, madje edhe në moshën 3 vjeç dhe përcaktuesit kryesorë të formimit të tyre i përfaqësojnë familja dhe mediat (Mihic et al, 2016:306).

Në mënyrë që të shqyrtojmë natyrën e stereotipeve të popullatës serbe ndaj shqiptarëve dhe popullatës shqiptare ndaj serbëve, të anketuarve u kemi dhënë **listën kontrolluese të stereotipeve** të standardizuar (Turjačanin, 2004) i cila përbëhet nga gjithsej 51 attribute, kurse detyra e të anketuarve është që të vendosin shenjën në të gjitha atributet që i konsiderojnë relevante për temën e vlerësimit.

Lista përbëhet nga atributet në vijim: të ashpër, llafazan, trima, të prapambetur, atdhedashës, të ftohtë, të pasinqertë, të hapur, vetëlavdërues, të shquar, mikpritës, punëtor, të disiplinuar, luftarak, të dhunshëm, të pastër, komunikues, të turpshëm, sfidues, dembelë, të përpiktë, primitivë, të papërpunuar, arrogantë, agresivë, të pasur, të përparuar, të mençur, të kulturuar, të mërziqshëm, afaristë, koprracë, fetarë, lakmitarë, të aftë, të pandershëm, gazmorë, të pistë, hokatarë, temperamentë, të zotë, dashnorë të mirë, nacionalistë, dyfytirësh, të gjindshëm, dinakë, miqësorë, fashistë, sensualë, të thjeshtë, krenarë. Si stereotipe u referohemi atyre tipareve që janë shënjuar nga mbi 50% të mostrave të të anketuarve. Rezultatet janë paraqitur në Tabelat 2 dhe 3.

**Tabela 2.1 atributet më të shpeshta negative të cilat pjesëtarët e komunitetit serb i shprehin ndaj shqiptarëve**

ATRIBUTET	Përqindja e të anketuarve
DYFYTYRËSH	67,4%
NACIONALISTË	63,1%
AGRESIVË	59,7%
TË DHUNSHËM	55,8%
DINAKË	51,5%

**Tabela 2.2 atributet më të shpeshta negative të cilat pjesëtarët e komunitetit shqiptar i shprehin ndaj serbëve**

ATRIBUTET	Përqindja e të anketuarve
NACIONALISTË	54,4%
RELIGJIOZË	52,7%
LAKMITAR	35%
DINAKË	28,9%
LUFTARAKË	28,2%

**Tabela 3.1 – atributet pozitive të cilat pjesëtarët e komunitetit serb i shprehin ndaj shqiptarëve**

ATRIBUTET	Përqindja e të anketuarve
PUNËTORË	36,1%
TË ZOTË	19,7%
TË GJINDSHËM	16,3%
KOMUNIKATIVË	13,7%
MIKPRITËS	13,7%

**Tabela 3.2 – atributet pozitive të cilat pjesëtarët e komunitetit shqiptar i shprehin ndaj serbëve**

ATRIBUTET	Përqindja e të anketuarve
ATDHEDASHËS	37,1%
PUNËTORË	34,7%
TË MENÇUR	31,6%
TË AFTË	30,6%
KRENARË	29,6%

Në bazë të grafikut vërejmë se perceptimet stereotipike ekzistojnë edhe te njëri edhe te komuniteti tjetër. Është gjithashtu e qartë se atributet negative janë më të shpeshta sesa ato më pozitive. Vlerat e attributeve negative janë dukshëm më të larta në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb në Kosovë. Bazuar në analizën e fokus grupit të pjesëtarëve të komunitetit serb, mund të dallojmë pikëpamjen dominuese se pjesëtarët e komunitetit serb janë në një pozitë të varur në Kosovë, dhe se pjesëtarët e komunitetit shqiptar "nuk trajtojnë ata si duhet", që mund të rezultojë në frustrimin e rritur të pjesëtarëve të komunitetit serb ndaj shqiptarëve që manifestohet përmes stigmatizimit stereotipik të shqiptarëve. Nga ana tjetër, anëtarët e bashkësisë shqiptare janë në një pozitë më të mirë në Kosovë, kështu që ata mund të jenë më pak të frustruar me anëtarët e komunitetit serb. Pjesëtarët e fokus grupit shqiptar kanë theksuar se propaganda dominuese politike dhe mediatike e cila zhvillohet ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb çon në formimin e këtyre stereotipeve, për shkak se këto attribute i përdorin edhe politikanët edhe mediat, kur flasin për shqiptarët.

## 2. Gatishmëria e pjesëtarëve të komunitetit serb dhe shqiptar për pajtim

Përveç distancës etnike dhe stereotipeve, studimi u përpoq për t'iu përgjigjur pyetjes nëse ka, dhe çfarë është natyra e tendencave drejt pajtimit te këta dy popuj. Për të adresuar hulumtuar këtë çështje, të anketuarve u kemi dhënë detyrë të plotësojnë shkallën e gatishmërisë për pajtim (Petroviq, 2005, 2017) e cila përbëhet nga 9 pohime (shembull i pohimeve: Besoj në pajtimin ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës; do të marrë kohë por marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës do të përmirësohen; serbët dhe shqiptarët e Kosovës kurrë nuk do të jenë më në gjendje t'i besojnë njëri-tjetrit, etj), kurse detyra e të anketuarve ishte të vlerësojnë shkallën në të cilën ata pajtohen me pohimin e dhënë. Llogaritjet rezultati total, kurse besueshmëria e shkallës është 0.80 (kufiri më i ulët me të cilin një instrument konsiderohet i besueshëm është 0.70). Rezultatet e testimit sa i përket dallimeve në gatishmërinë për pajtim te serbët dhe shqiptarët janë paraqitur në Tabelën 2.

**Tabela 2 – Testimi i rëndësisë së dallimeve në shkallën e gatishmërisë së shprehur drejt pajtimit te pjesëtarët e komunitetit serb dhe shqiptar**


Statistika përshkruese	t test				
	AS	SD	t	df	P
<b>Shkalla e gatishmërisë së shprehur drejt pajtimit</b>					
pjesëtarët e komunitetit serb	25,26	5,28	-14,75	520,1	<b>0,00</b>
pjesëtarët e komunitetit shqiptar	32,55	6,06			

Legjenda: AS – Mesi aritmetik; DS – devijimi standard; N – numri i të anketuarve; t – vlera e statistikave; df – shkallët e lirisë; p – rëndësia e statistikave.

Rezultatet tregojnë se pjesëtarët e komunitetit shqiptar shfaqin një shkallë më të lartë tendence drejt pajtimit (AS=32.55) në krahasim me pjesëtarët e komunitetit serb (AS=25.26).


Sidoqoftë, në të dyja rastet, vlerat e mesatareve aritmetike si në njërin ashtu edhe në komunitetin tjetër lëvizin më shumë në domenin mesatar, sesa që shfaqin një shkallë të lartë ose të ulët të gatishmërisë për pajtim. Kjo gatishmëri e njëtrajtshme për të marrë pjesë realisht në procesin e pajtimit e cila ekziston te këto dy komunitete duhet të merret si pikënisje kur krijohen strategji që synojnë pajtimin e këtyre komuniteteve. Për këtë arsye, studimi para jush u mor edhe me faktorë që mund të përshpejtojnë rritjen e kësaj gatishmërie edhe te njëri edhe te komuniteti tjetër. Ndër të tjera, i kemi pyetur të anketuarit se cila është përvoja e tyre me pjesëtarët e nacionalitetit të kundërt, si dhe mendimin e tyre se në çfarë kushte mund të përmirësohen marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve dhe të përmirësohet bashkëpunimi i përgjithshëm socio-ekonomik. Rezultatet janë paraqitur në grafikët 2,3,4, 5, 6 dhe 7.

**Grafiku 2 – Çfarë janë përvojat e juaja në aspekt të bashkëpunimi afarist me shqiptarët (pyetja për komunitetin serb), përkatësisht serbët (pyetja për komunitetin shqiptar)**




Rezultatet tregojnë se një përqindje më e lartë e pjesëtarëve të komunitetit serb kishte mundësinë të bashkëpunonte me pjesëtarët e komunitetit shqiptar (65.7%), dhe dallimi i atribuohet numrit dukshëm më të lartë të shqiptarëve që jetojnë në Kosovë. Ndër të anketuarit, numri më i madh ishte i atyre që kishin edhe përvoja pozitive edhe negative në këto bashkëpunime (43.3%). Një përqindje disi më e vogël e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar (49.3%) ka pasur rastin të punonin me pjesëtarët e komunitetit serb, nga të cilët përqindja më e madhe (32.3%) veçuan se kanë pasur edhe përvoja pozitive edhe negative me rastin e atyre bashkëpunimeve.

**Grafiku 3 – Çfarë janë përvojat e juaja në aspekt të bashkëpunimit ekonomik me shqiptarët (pyetja për komunitetin serb), përkatësisht serb (pyetja për komunitetin shqiptar)**




Edhe në këtë situatë kemi një përqindje më të madhe të pjesëtarëve të komunitetit serb të cilët kanë pasur rastin të bashkëpunojnë privatisht me pjesëtarët e komunitetit shqiptar (73,4%), ka më së shumti prej atyre që kanë pasur Ekzistojnë edhe përvoja pozitive edhe negative në kontakte të tilla (48.1%). Edhe këtu përqindja është pak më e vogël te pjesëtarët e komunitetit shqiptar (69.7%) që ka pasur rastin të bashkëpunonte privatisht me pjesëtarët e komunitetit serb dhe ata kanë theksuar në përqindjen më të madhe se këto përvoja ishin edhe pozitive edhe negative (32.3%).

**Grafiku 4 – Në çfarë kushte mund të afrohen me njëri tjetrin serbët dhe shqiptarët?**




Ndërsa pjesëtarët e komunitetit shqiptarë, në përqindjen më të madhe (42.5%), si zgjidhje për afrimin midis serbëve dhe shqiptarëve e shohin hyrjen në BE; në anën tjetër, pjesëtarët e komunitetit serb janë të ndarë në këtë çështje. Disa mundësi e afrimit e shohin në bashkëpunimin ekonomik të popujve (31.8%), kurse ka një përqindje të caktuar të atyre që besojnë se serbët dhe shqiptarët nuk mund të pajtohen (28.3%).

**Grafiku 5 – Sipas mendimit tuaj, cili është shkaku i gjendjes së pafavorshme socio-ekonomike në Kosovë – përgjigjet e pjesëtarëve të popullatës serbe**






**Grafiku 6 - Sipas mendimit tuaj, cili është shkaku i gjendjes së pafavorshme socio-ekonomike në Kosovë – përgjigjet e pjesëtarëve të popullatës shqiptare**



Përqindja më e madhe e pjesëtarëve të komunitetit serb e shohin shkaktarin kryesor të bashkëpunimit të pafavorshëm socio-ekonomik në konfliktet etnike (32.6%), pastaj paaftësinë e politikanëve të cilësdo përkatësie etnike (24.9%), si dhe në paaftësinë e shqiptarëve për të udhëhequr Kosovën (21.9%); pjesëtarët e komunitetit shqiptar gjithashtu theksojnë pamundësinë e politikanëve të cilësdo etnie (32.7%) dhe paaftësinë e shqiptarëve për të udhëhequr Kosovën (27.9%) si faktorë të situatës së pafavorshme socio-ekonomike në Kosovë.

**Grafiku 7 – Është e rëndësishme të vjen deri te pajtimi i serbëve dhe shqiptarëve që gjeneratat e ardhshme të mund të jetojnë më mirë në këtë rajon.**



Nëse vëzhgojmë grafikun 7 shohim se në përqindje të madhe edhe për pjesëtarët e komunitetit shqiptar (88.5%) edhe për pjesëtarët e komunitetit serb (84.5%) është e rëndësishme që të vjen deri te pajtimi midis serbëve dhe shqiptarëve, ku pjesëtarët e komunitetit shqiptar në përqindje më të madhe kanë shprehur pajtimin me këtë pohim, ndërsa pjesëtarët e komunitetit serb janë të ndarë mes "plotësisht pajtohem se pajtimi është i rëndësishëm për brezat e ardhshëm" dhe "përgjithësisht është e rëndësishme të vjen deri te pajtimi për shkak brezave të ardhshëm".

Pjesëtarët e fokus grupit të serbëve gjejnë se gjetjet që lidhen me shkallën më të lartë të gatishmërisë për pajtim që treguan pjesëtarët e komunitetit shqiptar, e shohin në atë se serbët nuk ndjehen të sigurt në Kosovë, kurse pajtimi do të thotë ndikim i shqiptarëve në jetën e tyre, dhe kjo është arsyeja e jostabilitetit. Ata konsiderojnë se shqiptarët janë shumicë në Kosovë, dhe shumica janë, si rregull, më të hapur ndaj pakicave, d.m.th. pakicën e konsiderojnë më pak të rrezikshme. Më pas ata deklarojnë se serbët nuk e kuptojnë pajtimin si shqiptarët. Serbët me pajtim kuptojnë integrimin në shoqërinë kosovare, gjë që ata nuk e duan, dhe për këtë arsye më pak autonomi, kurse shqiptarët e shohin pajtimin si pranim të gjendjes aktuale, d.m.th. se ata kanë një shtet. Anëtarët e fokus grupit shqiptar pajtohen se shqiptarët janë në një pozicion më të mirë, sepse ata "nuk humbasin shumë" me rastin e pajtimit. Në të kundërtën, disa pjesëtarë të fokus grupit theksuan se pajtimi i dy kombeve pasqyrohet në një sërë hapash që duhet të marrë komuniteti serb. Hapat e parë pasqyrohen në kërkim faljen për krimet e luftës, kompensimin material të dëmit të pësuar gjatë luftës, duke vënë në dukje se edhe në qoftë se vjen deri te pajtimi ai do të jetë "pajtim funksional," por jo falje dhe harresë.

### 3. Identiteti kombëtar, religjioziteti dhe gatishmëria për pajtim

Identiteti kombëtar luan një rol të rëndësishëm në dinamikën e marrëdhënieve etnike. Rezultatet e hulumtimeve të mëparshme tregojnë se ekziston një korrelacion i rëndësishëm ndërmjet shkallës së identitetit kombëtar dhe distancës etnike ndaj pjesëtarëve të kombeve të tjera. Përveç identitetit kombëtar, një faktor që ka provuar të jetë i rëndësishëm është edhe religjioziteti.

Në kuadër të këtij hulumtimi kemi përdorur: *Shkallën e Identitetit Kombëtar, NAIT* (Çorkalo & Kamenov, 1998), që përbëhet nga gjithsej 27 pohime, vlera e rezultateve varion nga 27 në 135, rezultatet më të larta tregojnë një shkallë më të lartë të identitetit kombëtar. Besueshmëria e shkallës në mostrën e anketuar është 0.87 (kufiri më i ulët me të cilin një instrument konsiderohet i besueshëm është 0.70); dhe *Shkalla e religjiozitetit* (Kuzmanoviq, 1990), e cila përbëhet nga 6 pohime, vlera minimale është 6, maksimalja 30. Vlerat më të larta tregojnë një shkallë më të lartë të religjiozitetit. Besueshmëria e shkallës është 0.7. Rezultatet e testimit të ekzistencës së dallimeve në lidhje me këto dy dimensionet në mes të popullsisë serbe dhe shqiptare janë paraqitur në Tabelën 3.

**Tabela 3 – testimi i rëndësisë së dallimeve në shkallën e shfaqjes së identitetit kombëtar dhe shfaqjes së religjiozitetit te pjesëtarëve të popullatës serbe dhe shqiptare**

Statistika përshkruese	t test				
	AS	SD	t	df	P
<b>Shkalla e identitetit kombëtar të shprehur</b>					
pjesëtarët komunitetit serb	97,50	16,14	-1,44	525	0,15
pjesëtarët e komunitetit shqiptar	99,62	17,20			
<b>Shkalla e identitetit fetar të shprehur</b>					
pjesëtarët komunitetit serb	20,16	4,11	0,67	520,85	0,54
pjesëtarët e komunitetit shqiptar	19,89	5,66			


Legjenda: AS – Mesi aritmetik; SD – devijimi standard; N – numri i të anketuarve; t – vlera e statistikave; df – shkallët e lirisë; p – rëndësia e statistikave.

Rezultatet tregojnë se nuk ka dallim në mes të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe shqiptar në lidhje me shkallën e shfaqjes së identitetit kombëtar dhe religjiozitetit. Pjesëtarët e të dy popujve në masë të njëjtë shfaqin shkallë të lartë të identitetit kombëtar dhe shkallë të lartë të religjiozitetit. Kjo e dhënë është e rëndësishme në drejtim të zhvillimit të strategjisë


për pajtimin e këtyre komuniteteve, sepse theksuar rëndësinë e kultivimit dhe ruajtjes së karakteristikave kombëtare dhe fetare të të dy kombeve.

Për të shqyrtuar rëndësinë e fesë në marrëdhëniet ndërmjet popujve, të anketuarve u janë bërë dy pyetje. Një pyetje ka pasur të bëjë përgjithësisht me sa të shpeshta janë rastet e jotolerancës midis pjesëtarëve të feve të ndryshme (Grafiku 8), dhe pyetja e dytë ishte më konkrete dhe kishte të bënte me territorin ë të cilin jetojnë, përkatësisht se sa jotoleranca fetare e rrezikon paqen në atë territor (Grafiku 9).

**Grafiku 8 – Sipas mendimit tuaj a janë të shpeshta shfaqjet e jotolerancës ndërmjet pjesëtarëve të besimeve fetare të ndryshme**



**Grafiku 9 – Sipas mendimit tuaj a e rrezikon paqen në territorin në të cilin jetoni jotoleranca ndërmjet pjesëtarëve të besimeve fetare të ndryshme?**



Bazuar në grafikët 10 dhe 11, vërejmë se të anketuarit edhe të njërit edhe të komunitetit tjetër janë të ndarë sa i përket mendimit se ka një jotolerancë të shpeshtë në mes të pjesëtarëve të besimeve të ndryshme (36.5% pjesëtarë serb; 26.5% e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar) dhe se ky lloj i jotolerancës shfaqet nganjëherë (26.6% e pjesëtarëve serbë, 28.6% e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar). Në anën tjetër, pothuajse gjysma e komunitetit shqiptar (49.7%) dhe më shumë se gjysma e pjesëtarëve të komunitetit serb (69.5%) besojnë se jotoleranca e pjesëtarëve të feve të ndryshme rrezikon paqen në territorin në të cilin jetojnë. Pak më shumë se 30% e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar beson se nuk ka

jotolerancë të tillë, ndërsa përqindja e pjesëtarëve të komunitetit serb që e ndajnë mendimin e njëjtë është e papërfillshme (9.4%).

Duke pasur parasysh këtë të dhënë, na ka interesuar se cili është roli i fesë në gatishmërinë për pajtim, këtë e kemi hulumtuar duke përdorur analizën e shumëfishtë regresive (si parashikime kemi përdorur shkallët e shfaqura të nacionalitetit dhe religjiozitetit, dhe si kriter shkallën e shprehur të gatishmërisë për pajtim. Qëllimi i kësaj analize është të na tregojë nëse mund të parashikojmë gatishmërinë për pajtim në qoftë se e dimë se sa është dikush fetar dhe çfarë shkalle të shprehur të identitetit kombëtar ka). Pra, na ka interesuar se cilën pjesë të gatishmërisë për pajtim (cila % e variancës, nga totali prej 100%) mund ta parashikojnë duke njohur dy masat e përmendura (religjiozitetin dhe identitetin kombëtar). Rezultatet janë paraqitur në Tabelën 4.

**Tabela 4 – Testimi i mundësisë së parashikimit të tendencës për pajtim në bazë të njohjes së shkallës së shkallës së shprehur të identitetit kombëtar dhe religjiozitetit**

modeli	R	R <sup>2</sup>	F	df	p1
	0,24	0,06	15,88	2	<b>0,00</b>
	Koeficientet e standardizuara		Beta (β)	t	p2
Religjioziteti			-0,23	-5,36	<b>0,00</b>
Identiteti kombëtar			-0,02	-0,38	0,70

**Legjenda:** R – koeficienti i korrelacionit; R<sup>2</sup> – koeficienti i përcaktimit; F-vlera e statistikave; df – shkalla e lirisë; p1 – rëndësia e statistikave F; β – statistika e kontributeve individuale të dimensioneve; t – vlera e statistikave; p2 – rëndësia e statistikave t.

Rezultatet tregojnë se në 6% të varianteve tendenca për pajtim është a bazuar në identitetin kombëtar dhe religjiozitetin që i bie se gatishmëria për pajtim është më e madhe në atë masë sa është më pak i theksuar identiteti kombëtar dhe religjioz. Është e vërtetë se këta dy faktorë ndihmojnë në vetëm 6% të varianteve të gatishmërisë për pajtim (nga totali prej 100%), por duke pasur parasysh se sa faktorë gjithsej përcaktojnë prirjen për pajtim, kjo përqindje nuk është e papërfillshme.

Një prej arsyeve për këto rezultate që janë marrë në aspekt të rëndësisë së identitetit kombëtar dhe religjiozitetit për pajtimin në mes të dy komuniteteve, anëtarët e fokus grupit serb e shohin në keqpërdorimin shumëvjeçar të këtyre dy faktorëve për përhapjen e dhunës dhe theksimit të dallimeve midis këtyre komuniteteve. Ata besojnë se edhe mënyra se si njerëzit e interpretojnë fenë ka sjellë deri te ajo që të vjen deri te jotoleranca midis pjesëtarëve të grupeve religjioze të ndryshme. Rezultatet nga fokus grupi shqiptar ritheksojnë rëndësinë e shoqërisë ortodokse në politikën serbe, e cila propagandon se Kisha Ortodokse, feja dhe mitologjia luajnë rol të rëndësishëm në shoqërinë serbe.

## PËRFUNDIM

Me analizën e rezultateve të fituara përmes listës së stereotipeve dhe shkallës së distancës sociale mund të nxjerrim përfundimin e qartë se perceptimet stereotipike vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në definimin e marrëdhënieve midis serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Edhe pse është e dukshme se serbët shfaqin numër më të madh të stereotipeve ndaj shqiptarëve se sa që manifestojnë ndaj serbëve, është inkurajuese e dhëna se në më shumë se 80% rasteve këta dy popuj e vlerësojnë si të mundshme bashkëjetesën, sepse një përqindje e tillë e mostrës së anketuar e pranon pjesëtarin e kombësisë tjetër si qytetar të shtetit të vet, si fqinj, disa si mik, e madje ekziston edhe një përqindje e vogël e atyre që mund

ta paramendojnë veten në bashkëshortësi me pjesëtar të kombësisë shqiptare (serbët) ose të kombësisë serbe (shqiptarët). Prirja për pajtim të këtyre dy popujve është më e theksuar në mesin e popullatës shqiptare se sa në mesin e popullatës serbe (por sillet në një prirje të moderuar). Kjo hapje paraqet një nxitje të madhe për përpjekjet drejt pajtimit mes dy komuniteteve, por është e kushtëzuar nga një mori faktorësh të tjerë socio-politik (respektimi i të drejtave të të gjitha komuniteteve, të kuptuarit e interesave të tyre, mos rrezikimi i identitetit kombëtar e kështu me radhë). Prandaj, rekomandim i këtij hulumtimi është që përpjekjet e ardhshme drejt pajtimit duhet të fokusohen në identifikimin, prioritetimin e këtyre faktorëve (kushtëzimin) dhe përpjekjet drejt përmbushjes së tyre.

Në aspektin e marrëdhënieve afariste, shumica e të anketuarve kanë pasur përvojë me pjesëtarët tjerë, ndërsa ata që kanë pasur nuk kanë dhënë kualifikime mbizotëruese të këtyre përvojave si pozitive apo negative (përafërsisht të njëjta). Rëndësia e këtyre përvojave është më e madhe kur dihet se kontaktet mes dy komuniteteve në Kosovë janë kryesisht të lidhura me mjedisin afarist dhe rrethanat, kështu që kualifikimi i tyre si pozitive (apo negative) mund të ketë efekt të rëndësishëm në perceptimet e përgjithshme dhe mbizotëruese ndërmjet dy komuniteteve.

Shkaku kryesor i situatës së keqe socio-ekonomike në Kosovë nga pjesëtarët e të dy komuniteteve i atribuohet paaftësisë së politikanëve të të dy etnive si dhe paaftësisë së shqiptarëve për të udhëhequr Kosovën. Krahas kësaj, pjesëtarët e bashkësisë serbe si shkak i theksojnë edhe konfliktet etnike midis këtyre dy komuniteteve. Ajo që është ndoshta më e rëndësishme, të dy komunitetet mundësinë për pajtim e shohin në bashkëpunim i cili do të rezultojë në jetë më të mirë dhe më të begatë për të gjithë të anketuarit qoftë përmes përparimit të shoqërisë në integritet në BE (që lidhet me një shoqëri më të qëndrueshme dhe më të zhvilluar) qoftë përmes bashkëpunimit ekonomik. Për të gjithë ata që punojnë për pajtim, këto të dhëna ofrojnë udhëzime të qarta se si të krijohen me sukses programe të tilla.

Identiteti kombëtar dhe vetë religjioziteti në mesin e të anketuarve janë dëshmuar si faktorë të rëndësishëm që lidhen me prirjen për pajtim ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Ajo që është interesante është se të dyja shfaqin një shkallë të lartë të identitetit kombëtar, por ndërsa anëtarët e popullatës serbe në Kosovë veten e kanë quajtur kryesisht si serbë (228/233), pjesëtarët e popullsisë shqiptare kryesisht janë ndarë në shqiptarë (153/294) dhe kosovarë (132/294).

Nga analiza e rezultateve të fokus grupeve vërejmë se te ta mbizotëron mendimi se serbët janë minoritet në Kosovë dhe nga kjo rrjedh frustrimi më i madh ndaj pjesëtarëve të komunitetit shqiptar gjë e cila shprehet përmes stereotipeve më të theksuara dhe gatishmërisë më të vogël për pajtim.

**Gjithsesi se si e dhënë më e rëndësishme paraqitet fakti që më shumë se 80% e mostrës së anketuar, edhe të popullatës serbe edhe shqiptare, konsiderojnë se për një të ardhme më të mirë të brezave të ardhshëm është e domosdoshme dhe me interes që këta dy popuj të pajtohen.**

## Mutual Perceptions of Serbs and Albanians in Kosovo

Historical relations of Serbs and Albanian in the Western Balkans are marked with long lasting animosities and permanent tensions. Hostile sentiment prevailed over ethnic tolerance enthusiasm promoted in post-World War II Yugoslavia, leading to a grave deterioration of relations during the 1990's (the collapse of Yugoslavia.) The crisis resulted in an outburst of ethnic violence throughout 1998 and 1999, and the ensuing NATO intervention that introduced an international protectorate over the Yugoslav province of Kosovo. The intervention of the international community in '99 was aimed at the reconstruction of legal and institutional framework in Kosovo and its democratic potential, so it could further eradicate the inequalities and discriminatory practices that triggered the outburst of violence at the end of the 20th century. However, the process of re-building of an autonomous and democratic state was affected by the deep mutual distrust of the communities in Kosovo and residues of ethnic violence that, with varying intensity, have continued for a number of post-conflict years. Today, despite the tangible progress achieved in stabilization of ethnic relations and cooperation at political level, Kosovo still remains a divided society with deeply rooted inter-ethnic prejudices. Such a state of affairs is intentionally or inadvertently sustained and fueled by more or less all community actors, while the structural reconciliation and cooperation efforts are limited to the low-scale civil initiatives or narrow professional clusters (e.g businesses).

There are many factors that contribute and fuel the lingering ethnic conflicts in Kosovo. They vary in intensity and effects on ethnic relations, but their roots enable their classification into three groups.

1) **Unresolved political disputes.** A perpetual source of ethnic tensions in Kosovo as a result of political confrontations on matters related to the status of the Serbian minority in Kosovo and attainment of Kosovo's statehood at regional and international scene. While tangible progress has been achieved in the past several years (through the dialogue under EU auspices), an array on unresolved issues (membership in international institutions, institutional associations of Serbs in Kosovo etc.) still instigates ethnic tensions and enmities in Kosovo.

